

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Kaçanikut**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr <sup>1</sup> i prokurimit	652-26-665-2-1-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit me titull: "Mirmbajtja verore e rrugeve lokale"

### ANKESË

*Emri i plotë i kompanisë:*

REMA KOMPANI SH.P.K

*Adresa:*

Fusha e Pajtimit

*Vendi:*

Kaçanik

*Kodi postar:*

71000

*Numri Telefonit:*

044 654 456

*Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj:*

Arbërije Zharku

*Adresa elektronike:*

[remakompanishpk@outlook.com](mailto:remakompanishpk@outlook.com)

*Data e parashtrimit të ankesës*

10 prill, 2026

*Nënshkrimi dhe vula:*

*\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

<sup>1</sup> Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

## 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Me 19.02.2026: ----- Publikimi i Njoftimit për Kontratë në procedurë të hapur;  
Lloji i kontratës: ----- Shërbime  
Vlera e parashikuar: ----- 200,000.00 €  
Kriteri për dhënie: ----- Tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët;  
Me 31.03.2026: ----- Afati i fundit për dorëzimin e tenderit, ora 14:00;  
Me 25.03.2026: ----- Kërkesë për Rishqyrtim pranë AK-Zyra e Prokurimit- Komuna  
Kaçanik  
Me 31.03.2026: ----- Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim  
Me 10.04.2026: ----- Parashtrimi i ankesës në OSHP

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Ankesa parashtrohet në lidhje me dokumentet e tenderit, për të kundërshtuar kriteret që konsiderohen diskriminuese ose favorizuese, të përfshira në dosjen e tenderit. Këto kritere janë hartuar në kundërshtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe të Rregullores për Prokurim Publik (RRPP), dhe si rezultat, nuk sigurojnë pjesëmarrje të barabartë, të drejtë dhe jodiskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë.

## 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Më datë 25.03.2026, kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim, me objekt kryesor kundërshtimin e kritereve që kufizojnë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe krijojnë avantazhe të pajustificuara për një ose më shumë prej tyre, duke cenuar kështu parimin e konkurrencës së lirë, të drejtë dhe të ndershme.

AK, Komuna e Kaçanikut, me vendimin e datës 31.03.2026, e ka refuzuar kërkesën si të pabazuar. Megjithatë, vëmë në dukje se në arsyetimin e këtij vendimi, AK ka pranuar të bazuar së paku një nga pretendimet e ngritura nga ana jonë, ndërkohë që në dispozitiv ka vendosur në konkluzionin e kundërt, refuzimin e kërkesës në tërësi.

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Parashtruesi i kësaj ankese, OE "REMA KOMPANI" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues, Komuna e Kaçanikut, me vendimin e kundërligjshëm për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, veçanërisht me rastin e hartimit të kërkesave të kualifikimit/përzgjedhjes në dosjen e tenderit, ka vendosur kritere kufizuese dhe përjashtuese, të cilat synojnë pengimin e konkurrencës së drejtë dhe të barabartë, me qëllim të eliminimit të operatorëve ekonomikë të interesuar (kompanive profesionale) nga pjesëmarrja në këtë aktivitet të prokurimit, si dhe krijimin e favorizimeve të padrejta për operatorë të caktuar. Në këtë mënyrë, veprimet e AK si të tilla përbëjnë shkelje të parimeve themelore të barazisë, transparencës dhe konkurrencës së lirë, të garantuara me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 02/L-042 (versioni i konsoliduar), me Rregulloren për Prokurim Publik Nr. 001/2022, si dhe me konsistencën e aktiviteteve të natyrës dhe objektit së njëjtë të po këtij institucioni. Konkretisht, janë shkelur dhe anashkaluar dispozitat e mëposhtme:

### Dispozita të LPP:

- Nenin 1 në paragrafin 2 dhe 3 i LPP lidhur me nenin 4.3 i RRPP;
- Nenin 7 në paragrafin 2, 4 dhe 6 (i) dhe (iii) i LPP lidhur me nenin 4.3 të RRPP;
- Nenin 51 në paragrafin 1, 2, dhe 3 të LPP;
- Nenin 69 në paragrafin 1 të LPP;
- Nenin 108/A në paragrafin 2 dhe paragrafin 6 të LPP

### Dispozita të RRPP Nr. 02/2024 (Versioni i Konsoliduar):

- Nenin 4(3) të RRPP
- Nenin 17 në paragrafin 12 dhe 17 të RRPP;
- Neni 61 në paragrafin 1 dhe paragrafin 3 të RRPP.

*\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.*

### 1. Rrethanat procedurale të aktivitetit në fjalë.

- Më datë 19.02.2026, Komuna e Kaçanikut, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar në procedurë të hapur dosjen e tenderit për aktivitetin e prokurimit me titull: **"Mirmbajtja verore e rrugëve lokale"**, me numër të prokurimit 652-26-665-2-1-1, vlera e parashikuar prej 200,000.00€;
- Parashtruesi i kërkesës për rishqyrtim ka interes të ligjshëm për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, pasi plotëson kriteret e nevojshme, relevante dhe proporcionale të përcaktuara në nenet 65 deri 70 të LPP-së, duke disponuar kapacitetin e nevojshëm financiar, profesional dhe teknik, si dhe përvojën e duhur disavjeçare në fushën e infrastrukturës rrugore, të fituar nëpërmjet pjesëmarrjes dhe realizimit të projekteve të ngjashme në tendere të publikuara nga autoritete të ndryshme kontraktuese në Republikën e Kosovës.
- Megjithatë, nga shqyrtimi i dosjes së tenderit, parashtruesi ka konstatuar se një pjesë e konsiderueshme apo thelbësore e kriterëve të përzgjedhjes dhe kualifikimit që lidhen me kapacitetin teknik e profesional janë hartuar në kundërshtim me parimet e prokurimit publik dhe dispozitat e LPP, të cilat kërkojnë kriteret e nevojshme, relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e prokurimit. Kriteret e kontestuara bien ndesh me nenin 7 (paragrafët 2, 4 dhe 6 (i) dhe (iii)) dhe nenin 51 (paragrafët 1, 2 dhe 3) të LPP-së, duke kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke krijuar avantazhe të pajustificuara për operatorë të caktuar. Si të tilla, ato përbëjnë pengesa diskriminuese dhe kufizuese, në shkelje të parimeve të barazisë, proporcionalitetit dhe konkurrencës të garantuara me nenet 7, 51 dhe 69 të LPP-së, si dhe nenet 4(3) dhe 17(17) të RRPP-së.
- Në këto rrethana, duke u mbështetur në procedurën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, më datë 25.03.2026 parashtruesi i është drejtuar AK - Komunës së Kaçanikut, me kërkesë për rishqyrtim, me qëllim ndryshimin ose eliminimin e kriterëve të kontestuara, të cilat janë në kundërshtim me natyrën e aktivitetit të prokurimit dhe me kriteret bazike të parashikuara me dispozitat e LPP-së, RRPP-së dhe UPP-së.
- Megjithatë, ZPP i AK, me vendimin e nxjerrë më datë 31.03.2026, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim në tërësi si të pabazuar, pavarësisht faktit se e ka pranuar të bazuar së paku një nga pretendimet e ngritura nga ana jonë, ndërkohë që në dispozitiv ka arritur në konkluzionin e kundërt - refuzimin e kërkesës në tërësi. Arsyetimi i vendimit nuk prezenton asnjë fakt, provë apo argument konkret që të mbrojë ose justifikojë kriteret e kontestuara, dhe nuk jep asnjë shpjegim se përse pretendimet tona janë të pabazuara. Arsyetimi mbetet i përgjithshëm, i kundërthënës dhe i shkëputur nga rrethanat faktike të çështjes, pa u mbështetur në dispozitat konkrete të LPP-së dhe RRPP-së, duke lënë përshtypjen se është hartuar me ndihmën e mjeteve të inteligjencës artificiale, me formulime të stilizuara pa substancë juridike, të cilat, kur përdoren pa objektivitet dhe

pa argumentime të sakta, nuk mund të shërbejnë si bazë e vendimmarrjes të një organi publik, i cili është i detyruar të mbështetet në fakte, prova dhe dispozita ligjore konkrete, siç e kërkon detyrimi ligjor bazuar në parimin e ligjshmërisë.

- Për këto arsye, me anë të kësaj ankese i drejtohem OSHP-së, me qëllim mbrojtjen e të drejtës sonë ligjore, e cila mund të garantohet përmes një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm nga ana e institucionit tuaj, në përputhje me nenin 104, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP-së.

## 2. Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore

**Pretendimi i parë** Kundërshtimin e vendimit të AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE "REMA KOMPANI" SH.P.K., si vendim i pabazuar në fakte dhe në dispozita ligjore.

1. Autoriteti Kontraktues, me vendimin e nxjerrë më datë 31.03.2026, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të paraqitur nga OE "REMA KOMPANI" SH.P.K. Vendimi është nxjerrë pa dhënë asnjë arsyetim të argumentuar dhe të mbështetur në fakte apo në dispozitat përkatëse ligjore në lidhje me pretendimet e paraqitura.

**Në mënyrë më specifike, vendimi i kontestuar ka këto të meta thelbësore:**

- Vendimi bie ndesh me detyrimet e qarta ligjore të Autoritetit Kontraktues, nga neni 108/A paragrafi 12 i LPP-së, i cili kërkon shprehimisht që kundërshtimet e parashtruara të jenë të arsyetuara. Gjithashtu bie ndesh edhe me nenin 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton standardin minimal që duhet të përmbajë çdo akt administrativ: përshkrimin e kërkesës së palës, situatën faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore dhe arsyen e zbatimit të saj, si dhe arsyet për mospranimin e pretendimeve të palës.
- Asnjëri nga këto standarde nuk është përmbushur. Në vend të një shqyrtimi dhe një analize konkrete të pretendimeve të ngritura, ZPP i AK përkritazi me të gjitha pretendimet, veçanërisht përgjigjen ndaj pretendimit 1, është mjaftuar me pohime të përgjithshme si dhe parafrazime juridike të paragrafëve të nenit 7 dhe nenit 51 të LPP, duke pohuar se ka vepruar në harmoni me LPP-në dhe parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit, dhe se kriteret e vendosura janë proporcionale dhe të lidhura me objektin e prokurimit, pa e vërtetuar këtë situatë me asnjë fakt apo argument konkret. Një qëndrim i tillë nuk përbën arsyetim juridik, ai është thjesht një pohim i pambështetur në fakte, prova dhe ligj.
- Gjithashtu, ZPP i AK, duke injoruar objektin kryesor të pretendimeve ankimore, ka shkëlur detyrimin e tij ligjor të përcaktuar në nenin 24 të LPP-së, i cili e kufizon kompetencat e tij në vlerësimin e kriterëve të prokurimit dhe jo në vlerësime teknike jashtë fushës së tij. Konkretisht, ZPP i AK, në vend që t'i përgjigjet pretendimeve të ngritura, ka ndërtuar dhe argumentuar situata faktike të paqena, duke shprehur gjykime që i përkasin fushës së mekanikës, inxhinierisë së komunikacionit dhe kontrollit policor, fusha këto për të cilat AK nuk ka kompetencë ligjore dhe as ekspertizë teknike. Për më tepër, AK ka sajuar pretendime që nuk janë pjesë e kërkesës ankimore të OE, si pretendimi i atribuar OE-së se "pesha e kamionit mund të shkaktojë dëmtim të rrugës" dhe më pas u është përgjigjur këtyre pretendimeve të sajuara sipas gjykimit të vet, duke krijuar kështu konfuzion të qëllimshëm të

gjendjes faktike dhe duke devijuar shqyrtimin nga thelbi i ankesës. Ju lutem shiko përgjigjen në pretendimin 1 dhe 3, etj.

- Në këtë mënyrë, ZPP i AK ka bërë një vlerësim të gabuar të gjendjes faktike, duke mos i analizuar pretendimet tona në raport me kriteret ligjore dhe me praktikën e vet të mëparshme në procedura të ngjashme prokurimi. Me këtë vendim dhe konkretisht dosjen e tenderit, AK ka shkelur dispozitat e nenit 7 në paragrafin 2, 4 dhe 6 (i) dhe (iii), nenit 27, nenit 28, nenit 51 paragrafët 1, 2 dhe 3, si dhe nenit 69 paragrafët 1, 6.3 dhe 6.4 të LPP-së, si dhe nenit 17 paragrafi 17 të RRPP-së, të cilat përcaktojnë se kriteret e kualifikimit duhet të jenë të nevojshme, relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës, pa kufizuar konkurrencën apo favorizuar operatorë të caktuar. Për më tepër, ZPP i AK i është shmangur detyrimit të tij ligjor për të analizuar faktet e paraqitura në raport me gjendjen faktike dhe ligjore, dhe për të korigjuar kriteret e kontestuar, edhe pse konsiderojmë se ishte në dijeni se ato vërtetojnë karakterin kufizues dhe favorizues të kriteve në fjalë. Kjo vërehet edhe më qartë në faktin se AK ka përdorur referenca joadekuata dhe ka manipuluar përshkrimin e dispozitave ligjore në mënyrë të tillë që t'i shmangej përgjigjes së drejtpërdrejtë ndaj pretendimeve tona, duke tejkaluar kështu diskrecionin e lejuar ligjor.
- Përveç mangësive të lartcekura, ZPP i AK ka shkelur edhe afatin procedural të përcaktuar në nenin 108/A paragrafi 6 të LPP-së. Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar më datë 25.03.2026, ndërkohë që vendimi është nxjerrë më datë 31.03.2026, pra pas skadimit të afatit ligjor prej tre ditëve pune. Ndonëse e njëjta dispozitë parasheh mundësinë e zgjatjes së këtij afati për tre ditë shtesë, kjo e drejtë është e kushtëzuar shprehimisht me njoftimin paraprak të ankuesit, kusht ky që nuk është përmbushur në rastin konkret, pasi OE "REMA KOMPANI" SH.P.K. nuk ka marrë asnjë njoftim të tillë. Rrjedhimisht, KAK ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A paragrafi 6 të LPP-së, duke e tejkaluar afatin ligjor pa plotësuar kushtin e domosdoshëm që do ta lejonte një gjë të tillë.

**Përfundim:** Për këto arsye, konsiderojmë se vendimi i AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nuk përmbush standardet ligjore të arsyetimit dhe është vendosur në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe RRPP-së, si dhe me parimet bazike të procedurës administrative. Si i tillë, ai duhet të shpallet i paligjshëm. Andaj kërkojmë që OSHP-ja të konstatojë këtë shkelje ligjore

**Ju lutem shihni vendimi i AK për refuzim të kërkesës për rishqyrtim**

**Në vijim paraqiten pretendimet ankimore të parashtruara pranë AK nëpërmjet Kërkesës për Rishqyrtim të datës 25.03.2026, të cilat mbështeten në fakte konkrete dhe analiza ligjore që dëshmojnë shkelje të dispozitave përkatëse të LPP-së dhe akteve nënligjore në fuqi.**

#### **Pretendimi i dytë (Pretendimi i parë i Kërkesës për Rishqyrtim)**

**Shkelje e parimeve të barazisë/jodiskriminimit në procesin e prokurimit publik**

2. Korniza ligjore e prokurimit publik, përkatësisht LPP si ligj material i zbatueshëm, si dhe aktet nënligjore RRPP dhe UPP, përcakton qartë parimet themelore dhe **obligimin**

e autoritetit kontraktues që të gjitha kërkesat, kriteret dhe specifikimet teknike të dosjes së tenderit të hartohen në përputhje me dispozitat ligjore dhe objektin e prokurimit, duke argumentuar relevancën dhe domosdoshmërinë e tyre, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca ndërmjet operatorëve ekonomikë, të mos krijohet diskriminim dhe të mos favorizohet asnjë operator ndaj të tjerëve.

- **Neni 7 (Barazia në trajtim/jo-diskriminimi)** përcakton se të gjitha procedurat e prokurimit duhet të respektojnë parimin e barazisë dhe konkurrencës së ndershme. Paragrafët 2 dhe 3 obligojnë autoritetin kontraktues të mos hartojë specifikime që reduktojnë ose eliminojnë konkurrencën dhe pjesëmarrjen, apo që krijojnë avantazh për një operator të caktuar.
- **Po ashtu, neni 28 (Specifikimet teknike)**, paragrafi 2, ndalon hartimin e specifikimeve që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë.
- **Në të njëjtin kuptim, neni 17, paragrafët 12 dhe 17 të RRPP-së**, përcakton se dosja e tenderit përbën bazën mbi të cilën operatorët hartojnë ofertat e tyre dhe se ajo nuk duhet të kufizojë konkurrencën apo të krijojë diskriminim ose favorizim për ndonjë operator.
- **Ndërkohë, neni 51 (Njofftimi i kriterëve të përzgjedhjes)**, në paragrafin 1, ndalon përfshirjen e kriterëve të bazuara në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga nenet 65-70 të LPP-së, duke përcaktuar se kriteret duhet të kufizohen vetëm në elementet e nevojshme për të siguruar aftësitë profesionale, financiare dhe teknike të operatorëve. Paragrafi 3 i këtij neni kërkon që të gjitha kriteret dhe dokumentet e kërkuara të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës përkatëse.

3. Megjithatë, kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional të paraqitura në nenin 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, përfshirë disa nga pajisjet e obligueshme të specifikuar në Aneksin 7, janë hartuar në kundërshtim me dispozitat e kornizës ligjore të prokurimit publik. Në rastin konkret, Aneksi 7 ka përfshirë kërkesa për pajisje të panevojshme, të kategorisë së gabuar për natyrën e projektit, me specifika tepër të ngushta teknike dhe pa kufij të balancuar, të cilat nuk kanë qenë të përfshira në aktivitetet e mëparshme për objektin e njëjtë. Si të tilla, këto kërkesa nuk janë hartuar në përputhje me dispozitat ligjore, nuk janë relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës, dhe si të tilla funksionojnë si barriera që kufizojnë konkurrencën, përjashtojnë operatorë me kapacitete të mjaftueshme dhe favorizojnë operatorë të caktuar.

4. Dhe për më tepër, kriteret e vendosura paraqesin devijime thelbësore nga praktika e mëparshme e të njëjtit institucion në aktivitete identike prokurimi (mirëmbajtja verore e rrugëve lokale), si dhe nga kriteret e aplikuara në aktivitete të barasvlefshme apo të kategorive më të larta (rrugë rajonale, nacionale, magjistrale dhe autostrada) të iniciuara nga Ministria e Infrastrukturës. **Kjo moskonzistencë e dokumentuar dëshmohet në tabelën krahasuese dhe shembujt konkretë të paraqitur në vijim:**

Nr.	Titulli i aktivitetit	Nr. i prokurimit
1.	Mirëmbajtja Verore e rrugëve ne Komunën e Gjilanit	651-25-725-2-1-1
2.	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e Rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për 3 vitet në vazhdim	205-25-4397-2-1-1

5. Për këto arsye, faktet dhe rrethanat e paraqitura dëshmojnë se veprimet e autoritetit kontraktues janë në kundërshtim me parimet themelore të barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme, cenojnë integritetin e procesit të prokurimit dhe përbëjnë shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 7, nenit 24, nenit 28, nenit 51 dhe nenit 69 të LPP-së, në lidhje me nenin 4(3) dhe nenin 17(17) të RRPP-së.

Në vijim, paraqiten pretendimet specifike dhe faktet argumentuese për secilën kërkesë të kapacitetit teknik dhe profesional të nenit 9.1 dhe 9.2 të dosjes së tenderit, përfshirë pajisjet e obligueshme të detajuara në Aneksin 7, duke sqaruar në mënyrë të plotë ndikimin e tyre kufizues, diskriminues apo favorizues në procesin e vlerësimit.

#### **Pretendimi i tretë (Pretendimi i dytë i Kërkesës për Rishqyrtim)**

OE ankues konsideron se ky pretendim nuk ka nevojë të përshkruhet dhe vlerësohet nga OSHP, përderisa AK e ka pranuar si të bazuar dhe e ka adresuar në vendimin e tij, duke u zotuar për korrigjimin përkatës të tij përmes një njoftimi për korrigjimin e dosjes së tenderit në përputhje me procedurat ligjore në fuqi.

#### **Pretendimi i katërt (Pretendimi i tretë i Kërkesës për Rishqyrtim)**

Në kuadër të këtij pretendimi paraqiten pretendimet specifike dhe faktet argumentuese që dëshmojnë kriteret kufizuese apo përkundrazi favorizuese për secilën kërkesë të kapacitetit teknike lidhur me pajisjet e obligueshme të kërkuara në dosjen e tenderit, të cilat konsiderojmë se nuk janë të nevojshme dhe as relevante në raport me objektin dhe përmasat e kontratës, si dhe nuk janë të mbështetura me nevojat teknike të projektit dhe paramases.

Nr. 1

Kamion kiper me peshë bartëse min 22 ton

Kërkesa për të pasur një kamion me peshë bartëse min 22 ton, duke ju referuar kufirit me parametër kinse minimal, përbën specifikim të ngushtë teknik dhe të pajustificuar, i cili nuk e përfshin një balancë të drejtë në mes kufirit maksimal dhe kufirit minimal, dhe i cili është në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të përcaktuar me dispozitat ligjore përkatëse të LPP. Konkretisht, vendosja e një kufiri të pabalancuar "minimal" të vetëm e që në realitet nuk është kufi minimal por maksimal, nuk është një dosmosdoshmëri teknike por si mjet i barrierës teknike për të ngushtuar/kufizuar artificialisht konkurrencës e lirë në mesin e OE dhe përkundrazi për të favorizuar operatorë të caktuar që disponojnë pajisje të këtij parametri specifik.

Për më tepër, kjo kërkesë është gjithashtu e panevojshme dhe e tepërt, për faktin se dosja e tenderit në numrin rendor 2 kërkon tashmë një pajisje identike, kamion kiper me peshë bartëse minimum 10 ton, e cila, duke pasur parasysh natyrën dhe përmasat e kontratës, është kapacitet i mjaftueshëm dhe proporcional me objektin e prokurimit. Kumulimi i dy kërkesave për pajisje të të njëjtit lloj, me parametra të ndryshëm dhe të pajustificuara teknikisht, shërben si barrierë që përjashton operatorë me kapacitete të mjaftueshme dhe të nevojshme konform kriterëve të nenit 51 dhe nenit 69 të LPP dhe u krijon avantazh të padrejtë operatorëve të caktuar, duke e përshtatur sipas nevojave të tyre personale.

Prandaj kjo kërkesë teknike sa i përket kufirit me parametër kinse minimal, e që realisht është maksimal, pa përfshirë një kufi minimal (mesatar 10 ton) dhe maksimal (deri 20

ton) për të siguruar një balancë të drejtë mes kërkesave teknike dhe mundësive të ofruesve të ndryshëm, nuk është relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës, dhe si të tillë shërben si barrier që e kufizon konkurrencën, përjashtojnë operatorë me kapacitete të mjaftueshme dhe favorizojnë operatorë të caktuar në mënyrë që që ta paracaktoj si fitues të kontratës në mungesë të konkurrencës reale.

#### Shtojcë: Kundërshtim i arsytimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi

- Arsyetimi i ZPP të AK se kamionët e kësaj kategorie janë mjete standarde në sektorin e ndërtimit dhe se pesha shpërndahet në disa boshte duke mos e tejkaluar ngarkesën boshtore ligjore, nuk e justifikon kërkesën. Përkundrazi, e konfirmon të kundërtën e qëllimit të tij, duke pranuar se kamionët e kategorisë me kufi minimal 10 ton janë mjete standarde që operojnë ligjërisht në sektorin e ndërtimit, AK në fakt dëshmon se kërkesa për minimum 22 ton nuk ka bazë teknike të domosdoshme. Konkretisht kjo konfirmohet edhe nga fakti se vetë AK në numrin rendor 2 të dosjes së tenderit për të njëjtin objekt kontrate kërkon kamion kiper me minimum 10 ton, parametër që AK vetë e konsideron të mjaftueshëm. Vendosja paralele e dy kërkesave për të njëjtën pajisje me parametra kaq të ndryshëm, pa asnjë justifikim teknik të dokumentuar, dëshmon se kërkesa në numrin rendor 1 nuk buron nga nevoja reale e kontratës, por përbën kriter artificial me efekt kufizues të konkurrencës, në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 51 të LPP-së. Kështu që, formulimi teknik "minimum 22 ton" përbën manipulim teknik të parametrin, pasi në realitet dhe nga pikëpamja teknike ky nuk është kufi minimal, ai është de facto kufi maksimal i kategorisë standarde të kamionëve kiper të përdorur në sektorin e ndërtimit
- Krahas kësaj, ZPP në përgjigjen e tij, shkon përtej kompetencave të tij duke u futur në vlerësime të natyrës teknike-inxhinierike, si shpërndarja e peshës në boshte dhe kapaciteti transportues, pa u mbështetur në asnjë studim teknik, normë specifike apo mendim ekspertit. Ky arsyetim nuk është produkt i vlerësimit të kriterëve të prokurimit, por i një gjykimi teknik të paautorizuar që tejkalon fushën e kompetencës së ZPP-së sipas nenit 24 të LPP-së. Për më tepër, AK i atribuon OE-së pretendimin fiktiv se "pesha e kamionit mund të shkaktojë dëmtim të rrugës...", pretendim ky që nuk është pjesë e Kërkesës për Rishqyrtim, dhe më pas i përgjigjet këtij pretendimi të sajuar, duke devijuar qëllimshëm shqyrtimin nga thelbi i ankesës dhe duke krijuar konfuzion të gjendjes faktike.

**Propozim:** Për këto arsye, kërkojmë nga AK që paisja e tillë të largohet tërësisht nga kërkesat e dosjës së tenderit. Apo kjo pajisje apo pajisja me numër 2 të zëvendësohet me kufirin e balancuar në mënyrë të drejtë që përfshin kufirin minimal prej 10 dhe kufirin maksimal deri në 20 ton.

Nr. 10

Minieskavator me zingjir gome deri në 1 ton

Kërkesa për të pasur në dispozicion një minieskavator me peshë deri në 1 ton, përbën specifikim teknik të ngushtë që vendos vetëm kufi maksimal e që në realitet është minimal pa përcaktuar kufirin minimal të këtij lloji të minieskavatori, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit të garantuar nga dispozitat përkatëse të LPP-së.

Për më tepër, parametri "deri në 1 ton" i përket një kategorie pajisje me kapacitet të pamjaftueshëm për kryerjen efektive të punimeve të parashikuara në projekt. Në praktikë, për punime të kësaj natyre përdoren minieskavatorë me peshë operative nga

1.5 deri në 3.5 ton, të cilët ofrojnë stabilitet më të mirë në terren, fuqi gjurmimi adekuate, rezistencë ndaj kushteve të ndryshme të punës dhe efikasitet operacional superior. Minieskavatori "deri në 1 ton" nuk i plotëson parametrat minimal operativ, duke e bërë kërkesën joproporcionale por edhe jofunksionale në raport me objektin e kontratës.

Si e tillë kjo kërkesë specifike dhe e ngushtë është diskriminuese pasi është paraqitur në mënyrë që e eliminon dhe kufizon konkurrencën e hapur në mënyrë që t'iu pamundësohet pjesëmarrja OE të interesuar, pavarësisht kapaciteteve të plota dhe të nevojshme operative në raport me lëndën e kontratës, dhe nga ana tjetër t'iu krijohet avantazh favorizues OE të caktuar duke e përshtatur sipas nevojave të tyre personale.

#### **Shtojcë: Kundërshtim i arsyetimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi**

- Arsyetimi i AK-së se minieskavatori "deri në 1 ton" justifikohet nga nevoja për qasje në hapësira të ngushta dhe punime precize, e konfirmon pikërisht pretendimin e OE-së. Sepse, nëse qëllimi është qasja në hapësira të ngushta, atëherë parametri i duhur është kapaciteti operacional dhe dimensionimi fizik i pajisjes - jo pesha. Vendosja e peshës si kriter kufizues "deri në 1 ton" nuk garanton asnjë nga avantazhet operationale të pretenduara nga AK, pasi pajisje me peshë të ndryshme mund të kenë të njëjtat dimensionime dhe kapacitet pune. AK pra ka zgjedhur parametrin e gabuar teknik për të adresuar një nevojë reale operative, me efekt të drejtpërdrejtë kufizues ndaj konkurrencës.
- Pohimi i AK-së se "deri në 1 ton" është kufi maksimal i vendosur për shkak të kushteve në terren nuk qëndron. De facto kufiri minimal i cili është kufiri më poshtëm i kategorisë funksionale të minieskavatorëve, duke përjashtuar në mënyrë artificiale pajisje me kapacitet më të lartë - 1.5 deri në 3.5 ton apo eskavatorë të mesëm nga 3 deri në 10 ton, që mund të kryejnë të njëjtat punime me efikasitet të barasvlefshëm apo superior. Prandaj një justifikim i tillë që shërben për kufizim të konkurrencës dhe favorizim të OE që e disponojnë saktësisht këtë pajisje, nuk është kriter relevant dhe proporcional dhe as i domosdoshëm, përkundrazi, është specifikim i ngushtë pa justifikim teknik të dokumentuar, në kundërshtim me objektin e zërave të kontratës dhe me nenin 7, nenin 51 dhe nenin 69 të LPP-së. Kjo bie gjithashtu në kundërshtim me nenin 25 pika 18 të RRPP-së, i cili kërkon shprehimisht që kërkesat minimale të kualifikimit të formulohen në mënyrë që të mos përjashtojnë operatorë me kapacitete të arsyeshme dhe të mjaftueshme teknike.

**Propozim:** Për këto arsye, kërkojmë nga AK që paisja e tillë të zëvendësohet me kufirin e balancuar në mënyrë të drejtë që përfshin kufirin minimal nga 1.5 deri në 3.5 ton ose nga 3 ton dhe maksimal deri në 10 ton.

Nr. 12

**Makineri për prerjen e pusetave rrethore 360 shkallë me diametër deri 1.25m**

**Kërkesa e AK për të pasur një makineri për prerjen e pusetave rrethore 360 shkallë me diametër deri 1.25m, është e panevojshme, e paarsyetuar dhe joproporcionale me objektin dhe përmasat e kontratës.**

Kjo makineri është projektuar për punime - ndërhyrje strukturore të sofistikuar, prerje dhe instalim pusetash të reja, rindërtim dhe modifikim pusetash ekzistuese në beton ose asfalt dhe ndërhyrje të thella në strukturën e rrugës ose sistemin e kanalizimeve, punime këto që nuk parashikohen në asnjë zë të paramasës së këtij aktiviteti.

Kjo kërkesë nuk ka fare lidhshmëri me zërat e kontratës dhe nuk është relevante me pozicionet në paramasë, konkretisht zërat në pikën 1.7 dhe 1.8 të saj në të cilat kapakët e pusetave duhet të jenë të betonuara me bazë betoni me dimensione katrore 1.20x1.20 m dhe sillen të gatshëm në vendpunishte.

Rrjedhimisht, makina për prerje rrethore të pusetave 360 shkallë është dyfish e papërshtatshme: së pari, kryen prerje rrethore dhe jo katrore siç kërkohet nga paramasë; dhe së dyti, kapakët vijnë të gatshëm, pra operacioni i prerjes nuk kryhet fare në vendpunishte. Kjo e bën kërkesën jo vetëm joproporcionale, por teknikisht të panevojshme me zërat konkrete të kontratës.

Po ashtu, kjo makineri, nuk është relevante dhe ne proporcion me projektin, për faktin se në asnjë pozicion nga paramasa nuk ka furnizimin dhe montimin e kapakëve metalik, dhe si e tillë duhet të hiqet nga kërkesat e dosjes së tenderit.

Për më tepër, si e tillë, kjo kërkesë bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 17.17 të RRPP-së, duke kufizuar konkurrencën e hapur dhe duke krijuar kushte favorizuese për operatorë të caktuar, në mungesë të çfarëdo nevojë reale teknike të dëshmuar nga dokumentacioni i tenderit.

#### **Shtojcë: Kundërshtim i arsytimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi**

- Arsyetimi i AK-së nuk e adreson aspak argumentin qendror të pretendimit. Mospërputhja është e dokumentueshme matematikisht: paramasa parashikon pllakë betoni me dimensione  $1.20 \times 1.20 \times 0.20$  m, që gjeneron një diagonale prej rreth 1.69 m, vlerë kjo dukshëm më e madhe se kapaciteti maksimal i prerjes së makinës i kërkuar prej 1.25 m. Rrjedhimisht, makina e kërkuar fizikisht nuk e mbulon gabaritin e elementit konstruktiv të parashikuar në paramasë. Kjo nuk është çështje interpretimi apo preference teknike, por është mospërputhje gjeometrike e verifikueshme ndërmjet specifikimit të makinës dhe dimensioneve të vetë dosjes së tenderit.
- Pohimi i AK-së se pajisja siguron "funktionalitet specifik teknik" nuk përbën justifikim juridik, por konfirmon vetëm ekzistencën e pajisjes, jo përshtatshmërinë dhe relevancën e saj me zërat konkret të kontratës. Proporcionaliteti i një kriteri teknik matet me nevojën reale të projektit, jo me disponueshmërinë e pajisjes në treg.

**Propozim:** Për këto arsye, kërkojmë nga AK që paisja e tillë të largohet tërësisht nga kërkesat e dosjës së tenderit.

<b>Nr. 13</b>	<b>Makine hidraulike speciale per vendosjen dhe nivelizimin e pusetave me shtypje min 500bar</b>
---------------	--

Kërkesa për makinë hidraulike speciale për vendosjen dhe nivelizimin e pusetave me shtypje minimum 500 bar është e tepruar, joproporcionale dhe pa lidhje të drejtpërdrejtë me natyrën dhe përmasat e kontratës për mirëmbajtjen e rrugëve lokale.

Kjo pajisje është e specializuar për ndërhyrje të avancuara ndërtimore, instalim dhe nivelizim preciz pusetash në kushte ndërtimi të ri ose rikonstruktimi të thellë, punime këto që tejkalojnë fushëveprimin e mirëmbajtjes rrugore lokale, e cila kufizohet në riparime sipërfaqësore, rregullime të thjeshta dhe mirëmbajtje funksionale.

Përcaktimi i parametrin të ngurtë dhe specifik "shtypje minimum 500 bar" nuk reflekton një standard funksional të nevojshëm për objektin e kontratës, ai përbën specifikim të ngushtë teknik që nuk lejon alternativa të barasvlefshme funksionale dhe redukton artificialisht pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Në mungesë të një lidhjeje të qartë me zërat konkretë të paramasës, kjo kërkesë nuk përmbush kriteret e relevancës dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 51 dhe nenin 69 të LPP-së, dhe bie në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së dhe nenin 28 të RRPP-së, i cili ndalon shprehimisht specifikimet teknike me efekt kufizues të konkurrencës, duke krijuar kushte favorizuese për operatorë të caktuar.

Si e tillë, kjo kërkesë përbën barrierë të panevojshme që kufizon konkurrencën reale dhe favorizon operatorë të caktuar, në kundërshtim me parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit të garantuar nga neni 7 i LPP-së.

#### **Shtojcë: Kundërshtim i arsytimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi**

- AK pohon se 500 bar përbën "kapacitetin maksimal të pajisjes" dhe se operimi praktik bëhet sipas nevojës konkrete në terren, duke pranuar kështu, paradoksalisht, se parametri 500 bar nuk është domosdoshmëri operative, por kapacitet rezervë. Nëse operimi real bëhet "sipas nevojës konkrete", atëherë vendosja e 500 bar si kërkesë minimale të detyrueshme nuk justifikohet nga nevoja reale e kontratës, ajo e ngushton artificialisht konkurrencën duke kërkuar kapacitet maksimal teknik për punime që në praktikë nuk e kërkojnë atë nivel force hidraulike.
- Për më tepër, arsytimi i AK-së nuk mbështetet në dispozita konkrete të LPP-së dhe RRPP-së, nuk referon asnjë fakt teknik të verifikueshëm dhe nuk lidhet me asnjë zë konkret të paramasës, por përmban formulime të përgjithshme dhe të stilizuara pa substancë juridike, në kundërshtim me detyrimin ligjor të arsytimit të aktit administrativ bazuar në parimet e ligjshmërisë dhe transparencës.
- Gjithashtu, logjika e AK-së përjashton de facto pajisje të të njëjtit funksion dhe kapacitet operacional, por me prodhim më të hershëm, të cilat janë tekniku funksionale dhe të lejueshme sipas legjislacionit në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare. Një qëndrim i tillë është i pabazuar juridikisht, ngase parametri vlerësues duhet të jetë funksionaliteti dhe përputhshmëria me standardet teknike në fuqi, jo vjetësia e modelit. Ndryshe, me të njëjtën logjikë, çdo pajisje e një gjenerate të mëparshme do të konsiderohej e papërshtatshme, pavarësisht nga kapaciteti i saj real operacional, qëndrim ky që bie ndesh me parimin e proporcionalitetit dhe barazisë të garantuara nga neni 7 i LPP-së.

**Propozim:** Për këto arsye, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kjo kërkesë të largohet në tërësi nga dosja e tenderit, si masë korrigjuese e domosdoshme për të siguruar përputhshmëri me parimet e barazisë në trajtim, proporcionalitetit dhe konkurrencës së lirë në procedurat e prokurimit publik.

Nr. 14

Cilindër gomë-gomë max.4 ton

Kërkesa e AK për të pasur në dispozicion pajisjen "Cilindër gomë-gomë max.4 ton" që i referohet specifikimit të ngushtë teknik, paraqet një kërkesë të tepruar dhe të panevojshme, pasi kufiri i paraparë max.4 ton nuk lidhet me objektin e kontratës.

Në aspektin teknik, kjo kategori pajisjeje dhe pajisje tjera të ngashme përdoret zakonisht për punime shumë të kufizuara, si trotuare, shtresa sipërfaqësore apo riparime, kanale, Për më tepër, kufizimi në maksimum 4 ton është arbitrar dhe teknikisht i pajustificuar, pasi përjashton pajisje të tjera që mund të jenë më efikase dhe të përshtatshme për kushte të ndryshme në terren.

Prandaj, kjo kërkesë bie ndesh me parimet e barazisë dhe proporcionalitetit të përcaktuara në nenin 7 dhe nenin 51 të LPP-së, si dhe me nenin 17.17 të RRPP-së, pasi përcakton një kusht përmes një pajisjeje me specifika të veçanta e cila nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me nevojat reale të punëve të parashikuara në paramasë për realizimin e kontratës dhe nuk justifikohet në aspektin teknik dhe funksional. Një kusht i tillë krijon pengesa të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve që posedojnë pajisje të përshtatshme, dhe njëkohësisht krijon avantazh apo favorizim të padrejtë për një operator të caktuar.

**Shtojcë: Kundërshtim i arsytimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi**

- AK pohon se kërkesa për cilindër gome-gome maksimum 4 ton përcakton "një standard të arsyeshëm për sigurimin e cilësisë së punimeve" dhe se cilindra me kapacitet të njëjtë funksional janë të disponueshëm në treg. Ky arsyetim është i paqëndrueshëm për dy arsye: së pari, nëse cilindra të barasvlefshëm funksionalë janë të disponueshëm në treg, atëherë AK vetë pranon se kërkesa nuk është kufizuese, por nuk shpjegon pse pikërisht parametri "maksimum 4 ton" dhe jo një kufi funksional i balancuar që përfshin edhe kapacitete të larta. Së dyti, vendosja e një kufiri maksimal të ngurtë pa justifikim teknik të dokumentuar nga paramasa dhe zërat konkretë të kontratës nuk përbën standard funksional, përbën kufizim teknik artificial që përjashton operatorë me pajisje të kapacitetit më të lartë, të cilat janë funksionalisht të barasvlefshme apo superiore për objektin e kontratës.
- Pohimi se kjo kërkesë respekton "parimin e trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë" mbetet i pambështetur, pasi AK nuk ka paraqitur asnjë studim teknik, normë specifike apo referencë nga dokumentacioni i tenderit që dëshmon se cilindri mbi 4 ton nuk e realizon të njëjtin funksion me efikasitet të barasvlefshëm.

**Propozim:** Për këto arsye, kërkojmë nga AK që të ndërmarrë masa korrigjuese në pajtueshmëri me rrethanat e aktivitetit dhe konform kornizës ligjore të prokurimit, ashtu që pesha e cilindrit "max 4" të zavendësohet me peshën e balancuar në mënyrë të drejtë që përfshin kufirin minimal prej 4 ton dhe maksimal deri në 10 ton.

Nr. 22

**Makinë spërkatëse për herbicide- e montuar në automjet, traktor ose vetëlëvizëse**

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues për makinë spërkatëse për herbicide të montuar në automjet, traktor ose vetëlëvizëse paraqet specifikim teknik të ngushtë dhe joproporcional në raport me natyrën dhe përmasat e kontratës.

Paramasa e aktivitetit parashikon shprehimisht realizimin e spërkatjes me "makineri adekuate - minitraktor me spërkatëse dhe spërkatëse dore", duke përfshirë kështu edhe mjete më të lehta dhe alternative të barasvlefshme funksionale.

Kërkesa e AK-së, duke kufizuar pajisjen ekskluzivisht në variante të montuara në automjet, traktor ose vetëlëvizëse, e ngushton artificialisht fushën e konkurrencës duke përjashtuar operatorë që disponojnë mjete të tjera adekuate të parashikuara nga vetë

paramasa, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit sipas nenit 51 dhe nenit 69 të LPP-së dhe nenit 7 lidhur me konkurrencën e lirë dhe mosdiskriminimin.

Si e tillë, kjo kërkesë rezulton në kufizim të konkurrencës, duke favorizuar operatorë që disponojnë pajisje specifike që nuk janë thelbësore për realizimin e kontratës.

#### **Shtojcë: Kundërshtim i arsytimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi**

- Përgjigja e AK-së ndaj këtij pretendimi nuk përmbush asnjë nga standardet minimale të arsytimit të kërkuara nga neni 108/A paragrafi 12 i LPP-së. AK është mjaftuar me një fjalë të vetme të përgjithshme, pa e përshkruar kërkesën e palës, pa e vlerësuar situatën faktike, pa cituar bazë ligjore dhe pa arsyetuar mospranimin e pretendimit, dhe për rrjedhojë, pa justifikuar arsyeshmërinë dhe relevancën e vendosjes së kësaj kërkesë në raport me objektin e kontratës. Një qëndrim i tillë është shmangie e qëllimshme e përgjegjesisë administrative.

**Propozim:** Për këto arsye, kërkojmë nga AK që kjo kërkesë të largohet nga dosja e tenderit, ose alternativisht të zëvendësohet me kërkesa për pajisje alternative të barasvlefshme funksionale (p.sh. kositëse), në mënyrë që të sigurohet përputhshmëri me parimet e proporcionalitetit, relevancës dhe konkurrencës së lirë në procedurat e prokurimit publik.

#### **Pretendimi i pestë (Pretendimi i katërt i Kërkesës për Rishqyrtim)**

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues që “pajisjet e ofruara të mos jenë të angazhuara në projekte tjera” paraqet një kriter të pajustificuar, joproporcional dhe pa bazë ligjore në kuptim të LPP

Në përputhje me nenin 69 të LPP-së, autoriteti kontraktues ka të drejtë të kërkojë dëshmi se operatori ekonomik disponon kapacitetet teknike dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e kontratës, por jo të imponojë kufizime absolute mbi përdorimin e tyre në aktivitete tjera ekonomike. Një kërkesë e tillë tejkalon qëllimin e verifikimit të kapacitetit teknik dhe ndërhyr në mënyrë të pajustificuar në organizimin operativ të operatorëve ekonomik. Formulimi në fjalë nuk është i lidhur drejtpërdrejt me realizimin e kontratës, pasi mjafton që operatori ekonomik të garantojë disponueshmërinë e pajisjeve në kohën dhe mënyrën e kërkuar për ekzekutimin e punimeve. Ndalesa absolute për angazhim paralel nuk është e domosdoshme për këtë qëllim dhe për rrjedhojë nuk përmbush kriterin e proporcionalitetit.

Si e tillë, kjo kërkesë krijon barriera të panevojshme për pjesëmarrje dhe kufizon konkurrencën, duke favorizuar operatorë të caktuar dhe duke përjashtuar operatorë ekonomik që kanë kapacitete reale, por që operojnë në më shumë se një kontratë njëkohësisht. Kjo bie në kundërshtim me parimet e trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës së lirë, të përcaktuara në nenin 7, si dhe me kërkesat e nenit 51 paragrafi 3 dhe nenit 69 të LPP-së.

#### **Propozim:**

- Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që kjo kërkesë të largohet në tërësi nga dosja e tenderit dhe të zëvendësohet, nëse vlerësohet e nevojshme, me një formulim proporcional që kërkon vetëm dëshmi për disponueshmërinë dhe angazhimin e pajisjeve për realizimin e kontratës, pa kufizuar përdorimin e tyre në projekte tjera.

### Shtojcë: Kundërshtim i arsyetimit të AK në përgjigjen ndaj këtij pretendimi

- Përgjigja e AK-së ndaj këtij pretendimi nuk përmbush asnjë nga standardet minimale të arsyetimit të kërkuara nga neni 108/A paragrafi 12 i LPP-së
- Arsyetimi i AK-së se kjo kërkesë justifikohet nga nevoja për "reagim të menjëhershëm" nuk qëndron, ngase reagimi i menjëhershëm është kërkesë operative e disponueshmërisë, jo ndalim absolut i angazhimit paralel. Këto janë dy koncepte të ndryshme: disponueshmëria garantohet kontraktualisht, pa qenë e nevojshme të kufizohet organizimi operativ i operatorit ekonomik. AK nuk ka paraqitur asnjë bazë ligjore që e autorizon një kufizim të tillë sipas nenit 69 të LPP-së.
- Arbitrariteti i kësaj kërkesë dëshmohet edhe nga mospërputhja e brendshme e dosjes së tenderit: për stafin e kërkuar nuk është vendosur asnjë kufizim i tillë – personeli mund të jetë i angazhuar njëkohësisht në kontrata të tjera, ndërsa pajisjet jo. Kjo asimetri e pajustificuar ndërmjet dy kategorive të kapacitetit teknik të të njëjtit operator ekonomik nuk ka bazë logjike dhe as ligjore – ajo dëshmon se kërkesa nuk buron nga nevoja reale operative, por është formuluar me qëllim ngushtimi të konkurrencës duke favorizuar operatorë të caktuar, në kundërshtim me nenin 7 dhe nenin 51 paragrafi 3 të LPP-së.

### 3. Përfundim me propozime

Andaj duke marrë parasysh të gjitha arsyet, faktet dhe provat e paraqitura si më lart, OE ankues REMA KOMPANI SH.P.K. i drejtohet OSHP-së me këtë ankesë, duke kërkuar që pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, administrimit të shkresave të lëndës dhe provave në shqyrtim kryesor, e në pajtim me nenin 104, 105 dhe 107 dhe 117 të LPP-së, të merr këtë:

#### V E N D I M

- **MIRATOHET E BAZUAR** në tërësi Ankesa e parashtruar nga OE REMA KOMPANI;
- **OBLIGOHET AK - Komuna e Kaçanikut** të ndërmerr veprime korigjuese për të korigjuar dosjen e tenderit në raport me kërkesat kufizuese apo favorizuese sipas propozimeve të bëra dhe në pajtueshmëri të plotë me parimet dhe kërkesat ligjore të LPP-së Nr. 04/L-042 dhe RRPP Nr.001/2022.
- **OBLIGOHET AK - Komuna e Kaçanikut** të zgjat afatin për dorëzimin e dosjes së tenderit së paku dhjetë (10) ditë nga dita në të cilën supozojmë se e korigjon dosjen e tenderit sipas propozimeve të bëra me këtë kërkesë për rishqyrtim.
- **OBLIGOHET AK - Komuna e Kaçanikut** që ankuesit t'ia bëjë kompensimin e shpenzimeve procedurale të cilat do të përfshijnë tarifën e ankesës dhe shpenzimet rrjedhëse për të përgatitur ankesën dhe për përgjigjet e kërkesave të ekspertit/ës shqyrtues/e apo panelit shqyrtues (aq sa do të përcaktohen nga PSH i OSHP-së).

### 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkakuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.*

Obligimit të kompenzimit të shpenzimeve procedurale, kompenzimit të dëmit, dhe fitimit të humbur që do kërkohet pastaj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura *Në mbështetje të ankesës bashkëngjitet të gjitha provat e cekura.*

Tabela krahasuese lidhur me paisjet e kwrkuara pwr tw njejtin aktivitet dhe nga i njejt AK

Lista e makinerisë në aktivitetin aktual - nr. i prokurimit: 652-26-665-2-1-1	Lista e makinerisë në aktivitetin paraprak – nr. i prokurimit: 652-23-12583-5-2-1
1. Kamion kiper me peshe bartese min. 22ton	1.Eskavator min. 20 deri 30 Ton
2. Kamion kiper me peshe bartese min. 10ton	2. Eskavator min. 15 deri 20 Ton
3. Kamion me kran me peshe bartese deri 6ton	3. Eskavator min. 7 deri 9 Ton
4. Autobot uji , me sistem para për pastrim dhe larje rrugësh dhe i pajisur me gyp për larje manuale në zona të vështira	4. Eskavator min. 5 deri 6 Ton
5. Kamion Cisternë (me thithje vakum dhe presion) për debllokimin dhe pastrimin e rrjetit të kanalizimeve me fuqi shtypje deri 200Bar me kapacitet 6 deri 9m3- litra uje me certikatë përkatëse	5. Eskavator min. 7 deri 9Ton , se paku 1 (nji) me goma
6. Kamion cisternë per pastrim te gypave te kanalizimit me peshe bartese min.9500kg dhe sonda-dizne min.300bar	6. Ngarkues minimum 5 ton
7. Eskavator me goma max. 6ton	7. Kamionë kiper min.10 m3
8. Makine vetshkarkuese (Dumper me goma)	8. Makin per grryerje te asfaltit
9. Ngarkues me goma me peshë max.3ton	9. Greder
10. Mini Eskavator me zingjir gome deri 1ton	10. Finisher per shtrirje te asfaltit
11. Eskavator me peshë deri 20ton	11. Kompresor ajri

12. Makineri per prerjen e pusetave rrethore 360 shkallë me diameter deri 1.25m	12. Prese asfaltit
13. Makine hidraulike speciale per vendosjen dhe nivelizimin e pusetave me shtypje min 500bar	13. Automjete Pick-up
14. Cilinder gome-gome max.4ton	14. Makin per pastrimin e rrugeve ,trotuareve maksimumi 6 ton
15. Vibrocilindër me peshë deri 12ton	15. Kamiona per pastrimin e rrugeve se paku
16. Frezë për gërryerje të asfaltit	16. Cilinder vibrues hekur hekur me peshe maksimumi 4 ton
17. Finisher për shtruarje asfalti	17. Cilinder vibrues hekur gomë me peshe maksimumi 7 ton
18. Grejder për nivelizim të zhavorit	18. Cilinder vibrues me peshe maksimumi 19 ton
19. Makinë prerëse për prerje gjatësore të asfaltit	19. Cilinderjo vibrues me peshe maksimumi 13 ton
20. Vibropllakë për ngjeshje me peshë deri 1 ton	20. Mixera se paku dy
21. Makinë spërkatëse për bitumen dhe emulsion	21. Kamion te paisur meborëheqeset(pllugjet) dhe shpërndares automaticte krypës
22. Makinë spërkatëse për herbicide- e montuar në automjet, traktor ose vetëlëvizëse	22. Hedhese e bores mekapacitete deri 10m largesi
23. Vibro-pllakë për ngjeshje me peshë deri në 2 ton	